



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL PEJË

Komiteti për Politikë e Financa

I.Numër: 060/01-30412

Pejë, datë: 15 Maj 2026

PROCESVERBAL

Nga takimi i IV-të i Komitetit për Politikë e Financa i KK-së Pejë, mbajtur me **15 maj 2026**, në orën 10:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, DKRS znj.Xhenet Syka Kelmendi, DÇPJ, z.Arianit Krasniqi, Kryesus i komisionit për Draft-status të Komunës Pejës, z.Islam Husaj, Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit, z. Avni Gashi, zyrtare administrative znj.Donjeta Morina dhe përfaqësuesit e OSCE-së dhe ZIP-it

Takimin e hapi dhe e udhëheqi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, i cili hapi diskutimin për rendin e ditës, dhe i sqaroj të gjitha pikat të cilat janë vendosur në rend dite. Dhe sqaroj se pika e 16 u shtua në rend dite.

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent u miratua ky rend dite,

Rendi i Ditës

1. 1. Aprovimi i rendit të ditës.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 17.04.2026.
3. Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin Statutit të Komunës së Pejës, pas procedurave të parapara për konsultim publik.
4. Rishqyrtimi i Vendimit Nr.01/2026 – mbi themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa - KPF në Komunën e Pejës, në bazë të kërkesës së MAPL për rishqyrtim, me nr. prot: 020-162/5, dt. 13.03.2026.
5. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale Byfeja e objektit të Teatrit.
6. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale Byfeja e objektit të Teatrit.
7. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në Novosellë - rivitalizimi i objektit.
8. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në Novosellë - rivitalizimi i objektit.
9. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale me qëllim të dhënies në shfrytëzim nga procedurat e këmbimit dhe shpronësimit.
10. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale me qëllim të dhënies në shfrytëzim nga procedurat e këmbimit dhe shpronësimit.
11. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për

formimin e komisionit të ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afat shkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme Komunale.

12. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për dhënien e Servitutes Reale për instalimin e kabllor nëntokësorë, ZK Sferkë në pronësi të Komunës së Pejës.
13. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimeve të komisionit për tituj nderi, dekorata, mirënjohje dhe falënderime për vitin 2026.
14. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Komitetit për Politikë dhe Financa për kompensimin e Komisionit për hartimin e draft Statutit të Komunës së Pejës, nr. prot. 016/01-14884, datë: 31 Mars 2026.
15. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Komitetit për Politikë dhe Financa për kompensimin e Komisionit të veçantë për tituj nderi, dekorata, medalje, mirënjohje dhe falënderime për vitin 2026, nr. prot: 01-060/01-12407, datë: 26 Shkurt 2026.
16. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës të ngritura nga anëtarët, në atë renditje siç janë pranuar:

2. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.

Nuk ka pasur.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 17.04.2026.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 8 votë pro, 1 anëtar nuk ka marr pjesë në votim, miratohet procesverbali i takimit të kaluar.

4. Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin Statutit të Komunës së Pejës, pas procedurave të parapara për konsultim publik.

Z. Ardit Berisha: fillimishtë ju falenderoj që keni pranuar me u mbajtur mbledhja 1 orë më heret dhe kerkoj falje se ju ka dasht me n dryshu agjenden e juaj. Sa i perket pikes lidhur për rekomandim për miratimin e Statutit të Komunës së Pejës qëndrimi i Lëvizjes Vetvendosje tash dihet edhe unë si anëtar i komisionit kam jep dorëheqje nga ky komision. Arsyet i kemi bërë të ditura dhe i din edhe komiteti edhe kuvendi komunal dhe ne nuk e përkrahim këtë formë të ngutshme të ndryshimit të statutit të Pejës. Sepse ky statut mer kohe deri sa të ndryshohet dhe për dy jave për neve është e pa pranushme dhe do të votojmë kundër kësaj pike.

Z. Bekim Morina: desha të përgezoj komisionin për punën që e kanë bërë dhe sa i perket mospjesëmarrja dhe largimi prej komisionit nuk besoj që është praktik e mirë. Ndërsa sa i perket

çështjes që po flitet që është përshpejtu i ka kalu të gjitha afatet ligjore dhe nuk ka probleme me procedura. Më mirë kishte me qenë me qenë prezent dhe mi jep vërtetjet dhe sygjërimet e juaja.

Z.Labinot Panxha: ne si komision e kemi bërë një punë të mirë, dhe jemi mundu që edhe vërejtjet dhe sugjerimet edhe nga kuvendi edhe nga qytetarët të inkurporohen në këtë Draft –Statut. Ku në nenin 55 z.Drin Veselaj i ka dhënë propozimin e tij dhe është shtu pika 1.15, ku thotë që vendimi i 1.14 duhet të miratohet nga kuvendi i Komunës së Pejës me 2/3 e votave. Kjo i bjen që z.Gazmend Muhaxheri apo kryetari tjetër që do vjen që vendos me shu një drejtori apo me shtu, apo me i bashku disa drejtori nuk e ka atë kompetencë pa ardh në kuvendin komunal të Pejës. Kjo ka qenë edhe vërejtja e Arditit dhe e VV-së dhe është marr parasysh një gjë e tillë, dhe nuk është arsye me thonë nuk po e votoj këtë draft-statut vetëm që janë përshpejtu afatet. Ndësa sa i perfekt mbështetjes edhe nga ana ime dhe nga ana e antares Edonjeta e ka pas mbështetjen tonë për metodologjinë e punës, mirpo nuk e ka marr mbështetjen e shumices prej anëtarve të tjerë. Por kjo nuk është arsye me u ndal dhe me jep dorëheqje dhe mendoj që edhe afatet janë respektu, nuk janë përshpejtu dhe nuk ka diqka të jashtë ligjshme. Po besoj dhe nese e shohin të udhës secili dhe nese nuk e kanë jashta programeve politike mendoj që ky status duhet të ecë tutje.

Z.Ardit Berisha: nuk dashta me u lshu shumë në këtë temë sepse qëndrimet tona si LVV i kemi bërë të ditura, është një fjalim që e kam mbajtur në kuvend dhe aty i kam thënë të gjitha. Sa i perket Labit që po thotë që janë respektu afatet, ky e din mirë që ditën e parë në takim ka qenë e paraparë 60 ditë me ju kry ky draft -statut. Dhe kjo nuk ka ardh nga anëtarët e komisionit por e ke pas si propozim nga ekzekutivi. Ka pas disa faza që është dasht me respektu e asnjë nuk është respektu. Nese koka marr parasysh ajo që na kena thonë që nuk duhet me pas kompetencë kryetari me ndryshu përbërjen e ekzekutivit dhe me rrit numrin e ekzekutivit me një vendim, ajo është në rregullë, por që janë shkel afatet ti e din 100% që janë shkel. Ju e dini që statutin as komisioni se ka hartu të ka ardh prej ekzekutivit propozim. Ndoshta kur te ka ardh ki mujt me pa edhe me kqyr me jep ndonje vërtetje, por si hartim nuk është bo nga komisioni. Po ashtu metodologjia që e kom paraqit unë nuk është marr parasysh dhe unë i kam shpreh paknaqësit e mija se nuk është marr parasysh. Kishte me qenë mirë me u punu me atë metodologji sepse e kishim pas një status të mirë, por të ka ardh ndryshimi i numrit të drejtorive pa ndonje analizë funksionale dhe financiare për komunën e Pejës. Pse po duhet me ndryshu kto drejtori, edhe në aspektin opozitar duhet me pas qëndrimin parimor kur ndryshohet numri i drejtorive dhe nuk po e kuptoj Aleanca qysh kaq lehtësishtë e pranon shtimin e drejtorive.

Z.Labinot Panxha: meqenëse jam pjesë e komisionit dhe në asnjë moment nuk duhet me leju me thon që ky komision ka bo shkelje të afateve apo shkelje ligjore. Unë besoj që ti e din sikurse e din të gjithë që shkelja e afati bëhet vetëm në rast kur ti i tjekealon afatet. Ti mundesh me thonë qekjo punë është kry në kohë rekorde para afateve, por me thonë janë shkel afatet nuk mendoj që është e udhës sepse nuk janë shkel. Aleanca i ka qëndrimet e qarta në këtë temë dhe e ka dërgu antarin e saj këtu, dhe ne nuk besoj që jemi pajtu ose e kemi miratu diqka që është e kundërligjshme. Po ashtu mendoj që Aleanca nese mundet me ardh në pushtet dhe mundet me punu me qato drejtori që janë shtu, por nese nuk mundet prap ka me dërgu një leter në kuvend

dhe ka me i zvoglu. Po ashtu nuk besoj që shtimi i ketyre drejtorive është pa analizë. Sepse dr.Islami i ka jep arsyetimit dhe meqenëse Ministritë e Linjes janë nda, duhet me u nda edhe drejtorit këtu. Nese drejtoria për digjitalizim i kontribon zhvillimit dhe punës nuk po besoj që ka diqka të keqe. Unë ndalna këtu që nuk ka shkelje të afateve.

Z.Islam Husaj: sa i perket statusit me daten 31 mars 2026 është aprovu dhe është formu një komision i kuvendit, i cili ka pas për detyrë me hartu statutin e komunës. Në piken 4 të ketij vendimi shkruhet se komisioni brenda 60 diteve nga data e formimit të hartoj Draft-Statutin. Kjo i bie që me 31 qershor duhet me qenë e kryme se bohen 60 ditë. Ne jemi mundu me respektu këtë afat të vendimit të kuvendit. Sa i perket materialit në fillim ditën e parë i kemi aprovu do afate. Mirëpo atë ditë është kërku me qenë një tekst bazë fillestar ku ne kishim me u nis me vazhdu tutje dhe me punu statutin. Në takimin e dytë e kemi sjellë një tekst fillestar që nuk ka qenë as draft as statut, por nje tekst ku kemi pas me u nis me hartu statutin. Në fund të muajit të kaluar është aprovu në kuvend si Draft dhe ka shku ne diskutim publik. Diskutimi publik ka qenë sipas rregullave 15 ditë me radh dhe me daten 13 para dy ditve është mbajt një takim për diskutimin publik. Në diskutim kanë qenë të njoftuar të gjithë anëtarët e kuvendit dhe të gjithë drejtorët e drejtorive, anëtarët e komisionit dhe shoqëria civile. Pjesmarrja ka qenë shumë e mirë sepse ka qenë plot salla qytetarë, anëtar të kuvendit dhe ekzekutivi. Aty janë propozu disa ndryshime nga z.Drin Veselaj. Propozimet e Drinit ka kërku që neni 55 që të hiqet nga teksti, dhe për nenin 64 ku bëhet fjalë për drejtori, drejtoria për kulturë dhe bashkëpunim me jashtë ka propozu të ndryshoj emrin dhe të quhet drejtoria për kulturë dhe diasporë. Ka propozu që drejtoria për mjedisë dhe parqe të mbetet vetem drejtoria për mjedisë. Pastaj e kemi mbajt takimin në ora 17:00 dhe i kemi trajtu të gjitha propozimet që janë dhënë nga diskutimet publike.Sa i perket nenit 55 si komison jemi pajtu që neni 55 pika 1.14 ku shkruhet tek përgjegjësit e kryetarit/es nxjerë vendim për dy apo më shumë drejtori komunale, shuarjen e një drejtorie, dhe themelimin e një drejtorie të re sipas nevojave të paraqitura në komunë në pajtimi me legjislacioni në fuqi. E kemi shtu një pikë 1.15 në të cilën thuhet se vendimet nga pika 1.14 duhet të miratohen nga kuvendi me 2/3 të votave. Në fund nga gjithë anëtarët e komisionit prezent qe kemi qenë është përpilu një tekst dhe është përcjellë tek ju. Pasi edhe mbledhja e kuvendit është në fund të muajit do të plotësohet edhe afati 60 ditë që e kemi pas në vendim.

Z.Naimi Bytyqi: po ashtu edhe sa i perket Arditi po e kuptoj se a është e tepërt shtimi i drejtorive është ngarkesë financiare dhe ajo është temë pak ma e rrond. Por unë po e shoh që u bo ma e mira te pika 1.15 se edhe njëhere jane kthy në fuqi 2/3 në vendimarrje.

Z.Islam Husaj: kemi pyet sa e i perket anës financiare dhe na kanë thënë qe stafi është vetem drejtorit do të ndahen. Ndryshimi i financave do të jetë vetem ndryshimi i pages së drejtorit nga një zyertarit që bëhet drejtor.

Z.Naim Bytyqi: unë po them që nese Arditi apo LVV ka ndonjë kërkesë me u plotësu dhe me u përfshi të gjithë dhe me qenë të kënaqur sepse ky statut ka me i mbet komunës ska me i shërby veq e veq kërkujt.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 6 votë pro, 2 votë kundër, 1 anëtar nuk ka marrë pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5.Rishqyrtimi i Vendimit Nr.01/2026 – mbi themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa - KPF në Komunën e Pejës, në bazë të kërkesës së MAPL për rishqyrtim, me nr. prot: 020-162/5, dt. 13.03.2026.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: po e kalojmë këtë pike dhe po e dërgojmë për shqyrtim në kuvend.

Z.Avni Gashi: MAPL i ka dërgu shkresë avokatures shtetërore që me dërgu këtë lëndë në gjykatë. Por në konsulltim me kryetarin brenda dites ku i kem kërku MAPL-së që në kuvend kemi me trajtu prap dhe më heret e kemi trajtu por nuk kemi gjet mirëkuptim. Pas shkrës tonë ata kanë tërheq vendimin me dërgu në gjykatë. Por ne në këtë seancë duhet patjetër me gjetë zgjidhje se për ndryshe kjo lëndë shkon në gjykatë pastaj edhe komuna e Pejës diskualifikohet në vitin tjetër prej çdo grandit për përfomancë të komunës.

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim

6.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale Byfeja e objektit të Teatrit.

Z.Arianit Krasniqi: e kemi pjesë të listës dhënjën në shfrytëzim byfen e objektit të teatrit dhe kemi vendos me jep në shfrytëzim me afat të shkurt prej 15 vitesh një sipërfaqe prej 71m², e cila ka me i shërby të gjithë atyre që e frekuentojnë teatrin.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 2 anëtar të përmbajtur, 2 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për miratim.

7.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale Byfeja e objektit të Teatrit.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: ky komision përbëhet nga 5 anëtar, dy anëtar nga kuvendi, dy nga ekezekutivi dhe një ka shoqëria civile.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 2 anëtar të përmbajtur, 2 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

8.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në Novosellë - rivitalizimi i objektit.

Z.Arianit Krasniqi: si në piken ma heret dhënja në shfrytëzim i një pjese në Novosellë na ka mbet një pjesë e pa shfrytëzushme dhe e kemi parapa me jep në shfrytëzim për një periudhë 15 vitesh. Ne po e bëjmë thirrjen që kush do që është i interesuar me marr në shfrytëzim. Kemi me i propozu dy veprimtari që kanë me i shërby komitetit.

Z.Labinot Panxha: jam kundër me jep këtë pronë në shfrytëzim, më mirë është me investu komuna dhe me bo kopshtë të fëmijëve së paku ajo rrethin aty me i qu fëmitë në kopshtë se sa me jep në shfrytëzim.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 1 anëtar të përmbajtur, 3 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

9.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në Novosellë - rivitalizimi i objektit.

Kryesusi Rexhep Kujrtbogaj:i njeiti rast po ashtu edhe ky komision përbëhet nga 5 anëtar, dy anëtar nga kuvendi, dy nga ekezkutivi dhe një ka shoqëria civile.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 1 anëtar të përmbajtur, 3 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim

10.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale me qëllim të dhënies në shfrytëzim nga procedurat e këmbimit dhe shpronësimit.

Z.Arianit Krasniqi: po bëhet fjalë për një pronë që u mendu të ipet në shfrytëzim për afat gjatë, prona gjendet afer pjesës ku po ndërtohen banesat për banimin e përballushem pjesa për fundi Birarisë. Ne po e bëjmë veq hapin e parë pastaj komisioni vazhdon me procedura tjera.

Z.Labinot Panxha: bëhet thirrja me u dhënë në shfrytëzim po supozoj po e mer Filan Fisteku , gjatë shpjegimit që e bone na tregove në parim që qekjo pronë ka me u dhënë me u ndërtu banesa. Nese e mer qaj Filani qat pjesë në shfrytëzim ai ka me lon fushë të futbollit. Nese e jep pronen për 99 vjet ai mundet me bo qka don me pronë. Fillimishtë duhet me dediku psh e jepim këtë pronë për 99 vjet pë ndërtim banesor.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 4 votë pro, 2 anëtar të përmbajtur, 2 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim

11.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat

gjatë të pronës së paluajtshme Komunale me qëllim të dhënies në shfrytëzim nga procedurat e këmbimit dhe shpronësimit.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: edhe ky komision përbëhet nga 5 anëtar, dy anëtar nga kuvendi, dy nga ekezekutivi dhe një ka shoqëria civile.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 1 anëtar i përmbajtur, 2 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

12.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit të ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afat shkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme Komunale.

Z.Arianit Krasniqi: komisioni për shqyrtimin e ankesave për secilen landë veq e veq përbëhet prej 5 anëtarve dhe ky komision ka mandat 2 vjeçar.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 1 anëtar i përmbajtur, 2 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

13.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për dhënien e Servitutes Reale për instalimin e kabllor nëntokësorë, ZK Sferkë në pronësi të Komunës së Pejës.

Z.Arianit Krasniqi: materiali për këtë pikë ka ardh sot dhe e kemi para vetes. Kemi marr kërkesë nga kompania meqenëse kufizohet me pronën komunale me marrë në shfrytëzim si Servitut. E kemi sjellë si propozim para juve që me bo zgjidhje që me dhënë këtë pjesë parcelë si Servitut pasi që rregullorja nuk e parasheh ndonje tarifë për servitut dhe ka mbet një investim i madhe peng i procedurave për të cilat ne skemi mujt me ju jep zgjedhje. Janë investitor gjerman dhe për me zhvillu projektin ju duhet një leter e cila ju jep atyre në shfrytëzim këtë pjesë për 40 vjet. Ne e kemi pa të rruges që mos me hup këtë investitor, dhe mos e i hup gjitha ato punë që kanë ardh deri ne këtë pikë, për me procedu tutje.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 1 anëtar i përmbajtur, 2 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

14.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Komitetit për Politikë dhe Financa për kompensimin e Komisionit të veçantë për tituj nderi, dekorata, medalje, mirënjohje dhe falënderime për vitin 2026, nr. prot: 01-060/01-12407, datë: 26 Shkurt 2026.

Znj.Xhenet Syka Kelmendi: drejtorja për kulturë rini dhe sport e ka menagju procesin administrativ. Sa i perket përgatitjes së dokumenteve, pranimit të emrave dhe propozimet. Duke qenë që konkursi apo thirrja ka qenë e hapur 30 ditë, ju kam sjellë me vete materialet tek DKRS kanë mbritur me kohë gjithësej 26 propozime për tituj të ndryshem mirënjohje, dekorata dhe qytetar nderi, prej tyre janë 10 Post Mortum. Një detaj duhem me ju tregu që ka ardh edhe një

propozim shtese nga anëtari Ilir Gashi i cili e ka propozu Ramë Dervish Ukaj për një mirënjohje “Lekë Dukagjini”. Në ndërkohë gjatë javës pasi ka kalu afati e ka sjellë edhe një CV dhe motivacion se pse e ka propozu. Po ashtu edhe Agim Bekë Nikçi e ka propozu ti ndahet mirënjohje Post Mortum për Vëllëzërit Nikçi nga fshati Dacaj është arsytimi dhe motivacioni. Ndërsa Muhamel Dubpljak e ka propozu për çmimin “Haxhi Zeka” z.Sahit Kandic si profil me vlerë në komitet. Gjithashtu një javë më vonë ka ardhur një tjetër propozim nga Ilir Gashi për një mirënjohje për z.Osman Grabovci për kontributin në arsim. Nese ju i votoni ato barten edhe në administrat dhe në intranet të drejtorisë.

Z.Bekim Morina: me rregullore a është e lejuar me ardh propozimi ose materiali më vonë?

Znj.Xhenet Syka Kelmendi: nuk shkrun askund një draft i tillë por vetem 3 emra kanë ardh mbas afatit, ju vendosni a mi votu a jo!

Z.Labinot Panxha: e pash që këtu janë propozu disa emra pas afatit, dhe për dijenin e të gjithëve 30 ditë ka qenë i hapur, pastaj është shty edhe 1 javë dhe i keni mar 26 propozime. Por po shoh emra që në rregullore që e kam lexu nuk përputhet me një mirënjohje të tillë. Ndërsa sa i perket emrave që na lexove nuk besoj që duhet me na adresu neve si KPF, sepse komisioni na bjen neve dhe ne ja rekomandojmë kuvendit dhe nuk jemi as ata që i refuzojmë dhe as ata që i aprovojmë dhe nuk ish dasht me ardh pa nënshkrimin e anëtarëve të komisionit. Këto emra i keni pranë të pas afatshme po qka nese dikush ka vendos sepse ka pas edhe qytetare që ju ka ik afati a jemi duke e diskriminu dikend a po i hym dikujt në hak!

Znj.Xhenet Syka Kelemendi: ju kemi sjellë me qenë në dijeni dhe po ju njoftoj se çka ka ndodh, dhe me vendimin e kryesutit dhe të kuvendit vendoset a me i votu a jo!

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: ka disa vite që nuk e kemi respektu rregulloren ashtu siq është e parapame dhe shumicen e rasteve jem i ngushtu se as si komision as si kuvend për shkak të personaliteteve nuk kemi mujt me i refuzu. Titujt si Post Mortum, Lekë Dukagjini, Haxhi Zeka ju kemi jep shumë personaliteteve. Sa i perket kërkesave tjera që kanë ardh pas afatit dhe nese ata i kanë të gjitha procedurat me nënshkrime e me gjitha, jam i pajtimit me kalu edhe këta emra.

Z.Labinot Panxha: dhe një vërejtje drejtoreshë që e kam pa në procesverbal unë nuk kam propozu si individ por në emer të grupit të AAK-së. Dhe një tjetër i merni ata emra që kanë ardh pas afatit dhe i vlersoni ju si komision pastaj na sjellni neve për aprovim.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: dhe një rast ka ardhur si propozim tek kryetari për titull Mirënjohje për një veprimtar një bashkëvendas i Naimit.

Z.Naim Bytyqi: ajo familje me të vertet e meriton fjala është për Zenel Hamz Hasanaj, ka qenë aktivistë shumë i vjeter i LDK-së në atë kohë. Dhe për të janë shkru këngë dhe mundeni me i gjet me të vërtet e meriton.

Znj.Xhenet Syka Kelmendi: mua më duhet vetem një cv dhe një motivacion dhe këtë rast KPF-ja mbetet propozuese.

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

15.Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës të ngritura nga anëtarët, në atë renditje siç janë pranuar.

Z.Islam Husaj: unë kam një kërkesë që të merret vendimi në kuvend që të paguhet komisioni për hartimin e Statutit. Edhe diqka ta keni parasysh që në këtë seancë apo tjetren ka me u formu komisioni për rregulloret e kuvendit, të cilat tash dalin nga statuti sepse kanë me ndryshu të gjitha rregulloret që i kemi pas në funksion. Unë po kerkoj prej komitetit që të paguhet komisioni për hartimin e statutit si çdo here.

Znj.Xhenet Syka Kelmendi: edhe unë vetem po e përcjelli që edhe komisioni për tituj nderi , dekorata ka kërku kompenzim.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e qesim në votim propozimin e z.Islam Husaj.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 7 votë pro, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: edhe propozimin e znj,Xhenet Syka e qesim në votim.
Nga të gjithë anëtarët prezent me 7 vota pro, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pjesë e këtij procesverballi është edhe audio incizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime të tjera nuk pat, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 12:20 h.

Procesmbajtësja,
znj. Donjeta Morina

